



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 626, Datë 13.06.2019**

**“ Mbi mosmarrjen në konsideratë të shkresës informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Njoftim për fillimin e auditimit të performancës “Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i relacionit në lidhje me shkresën informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Njoftim për fillimin e auditimit të performancës “Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare””.

**Baza Ligjore:** Neni 1, neni 2 dhe neni 24 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi shkresën informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Njoftim për fillimin e auditimit të performancës “Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare””;

**VËREN SE:**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, protokolluar me tonën nr. 362 prot., datë 9.6.2019 me lëndë “Njoftim për fillimin e auditimit të performancës “Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare””.
2. Me anë të kësaj shkrese informuese, KLSH bën me dije Autoritetin e Konkurrencës, se në përputhje me programin e tij vjetor të auditimit të datës 28.12.2018, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH, do të fillojë

auditimin e performancës në institucionin tonë me tematikë **“Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare”**, në bazë të nenit 10, 13 dhe 26 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

3. Autoriteti i Konkurrencës është një organ publik i pavarur në kryerjen e detyrave të veta. Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës që vepron si një organ kolegjal i përhershëm, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit përcaktohen në Kreun I, të ligjit nr. 9121/ 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar - “Organizimi dhe funksionimi i AK”. Ky Komision brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës, paraqet në Kuvend raportin vjetor të AK.
4. Ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre. Ky ligj vepron për të gjithë sektorët/ tregjet e ekonomisë pa dallim, dhe në bazë të këtij ligji, AK vlerëson rast pas rasti shkeljet e parashikuara në Pjesën II-“Kufizimet e Konkurrencës”.
5. Komisioni i Konkurrencës vlerëson se shkresa informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Njoftim për fillimin e auditimit të performancës **“Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare”**”, i referohet tregut të telefonisë celulare, për të cilin ka një autoritet rregullator përgjegjës - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), sipas ligji nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar, dhe auditimi me tematikën **“Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare”** çënon pavarësinë e veprimtarisë e AK, veprimtari e cila është e sanksionuar me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe si e tillë nuk duhet dhe nuk mund të merret në konsideratë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 1, nenit 2 dhe 24 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

- I. Të njoftojë Kryetarin e KLSH se shkresa informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Njoftim për fillimin e auditimit të performancës **“Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare”**”, çënon pavarësinë e veprimtarisë e Autoritetit të Konkurrencës, veprimtari e cila është e sanksionuar me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- II. Tregu i telefonisë celulare mbikëqyret dhe rregullohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), dhe shkresa informuese nr. 425/1 prot., datë 7.06.2019 nuk duhet dhe nuk mund të merret në konsideratë.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURENCËS

Eduard YPI

Leida MATJA

Adriana BERBERI

Helidon BUSHATI

()

()

()

()

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Juliana LATIFI

()

Kryetar